



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I ARKEOLOGJISË DHE TRASHËGIMISË KULTURORE

PROGRAMI I LËNDËS
Drejtimi : Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore

TITULLI I LËNDËS: POLITIKAT PUBLIKE TË TK

Pedagogu: Akademik Prof. Dr. Artan Fuga
Ngarkesa: 4 ECTS (30 leksione dhe 15 seminare)
Lloji i lëndës: lëndë me zgjedhje
Programi i studimit: bachelor
Viti/Semestri: III/I

EKSTRAKT

Politikat kombëtare kulturore kanë për qëllim mbështetjen e sistemeve të qëndrueshme të qeverisjes së kulturës. Kjo lëndë synon identifikimin dhe analizën e këtyre politikave dhe krahasimin e tyre me parimet e formuluar nga UNESCO. Ideja qendrore e diskutimeve do të jetë roli i politikave kombëtare në promovimin e krijimit, shpërndarjes dhe aksesit të të mirave dhe shërbimeve kulturore. Veç të tjerash, do të shihet roli i politikave kulturore në promovimin e mobilitetit të artistëve dhe profesionistëve të TK në vende të ndryshme të botës. Një rol të rëndësishëm kanë politikat e zhvillimit të qëndrueshëm në përfshirjen e TK, si një dimension strategjik i tyre. Grupi tjetër i rëndësishëm i çështjeve që diskutohen përfshijnë rolin e TK në promovimin e të drejtave të njeriut dhe lirive të tij themelore.

TEMAT:

- LEKSION 1.** Hyrje. Përmbajtja dhe historia e politikave publike për TK në Shqipëri.
- LEKSION 2.** Vlerësimi dhe korniza monitoruese e politikave publike në sektorin e TK.
- LEKSION 3.** Politikat kulturore në mbështetje të krijimit, shpërndarjes dhe aksesit të vlerave kulturore.
- LEKSION 4.** Politikat publike të TK dhe mediat e shërbimit publik.

LEKSION 5. Politikat publike të TK dhe mjedisi dixhital.

LEKSION 6. Partneriteti me shoqërinë civile dhe roli i saj në artikulimin e politikave publike të TK.

LEKSION 7. Politikat publike dhe mobiliteti i krijuesve dhe profesionistëve të TK.

LEKSION 8. Lëvizja e lirë e të mirave dhe shërbimeve kulturore.

LEKSION 9. Politikat publike dhe marrveshjet ndërkombëtare. Konventat e UNESCOs për politikat publike të TK.

LEKSION 10. Politikat dhe planet kombëtare të zhvillimit të qendrueshëm.

LEKSION 11. Programet ndërkombëtare në mbështetje të zhvillimit të qendrueshëm kulturor..

LEKSION 12. Politikat kombëtare kulturore dhe të drejtat themelore të njeriut.

LEKSION 13. TK dhe barazia gjinore.

LEKSION 14. TK dhe liria artistike.

LEKSION 15. TK dhe të drejtat e autorit.

FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT

FREKUENTIMI:

70% pranisë në seminare e domosdoshme.

15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)

25 % e notës përfundimtare.

DETYRA E KURSIT:

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 3- 5 faqe format A4, Times Neë Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)

20 % e notës përfundimtare

KONTROLLI PËRFUNDIMTAR:

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri

40 % e notës përfundimtare

DETYRIMET E STUDENËVE PËR LËNDËN

Frekuentim i rregullt në leksione.

Frekuentim i detyruar në të paktën 70% të seminareve të lëndës.

Përgatitja e një ese-je nga 3-5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5.

Pjesëmarrje në testet e pjesshme gjatë semestrit.

Testi (provimi) përfundimtar (i fundit të smestrit)

LITERATURA:

1. *Ligji për Trashëgiminë Kulturore.*
2. *Ligji për të drejtat e autorit.*
3. *Re-shaping cultural policies.* UNESCO 2015.
4. Silverman and Ruggles *Cultural Heritage and Human Rights.* Springer 2007.